



Hapet Thirrja për Mobilitete (Bursa) Studentësh të UPT-së në kuadër të Marrëveshjes Erasmus + , në Universitetin Teknologjik të Compiegne, Francë dhe Universitetin e Genovës, Itali.

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 biletarale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët të Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT), Fakulteti i Teknologjise se Informacionit, në Universitetin Teknologjik te Compiegne (UTC), në Francë dhe në Universitetin e Genovës (UNIGE) në Itali.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** (studentët duhet të jenë të regjistruar në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike, Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni, në Universitetin Politeknik të Tiranës).
- **Master i Shkencave** (studentët duhet të jenë të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave ne Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni, në Universitetin Politeknik të Tiranës).

Në kuadër të bursave Erasmus+ është gjithashtu e mundur që të zhvillohet në UTC, praktika e vitit të dytë, e nivelit Master i Shkencave.

Kohëzgjatja e bursave:

- Numri i total i bursave/mobiliteteve në dispozicion për këtë thirrje, për nivelin Bachelor dhe Master i Shkencave së bashku është: 5 mobilitete (studentë) , 6 muaj çdo mobilitet (një semestër), në secilin nga universitetet pritëse.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor dhe Master i Shkencave:

- CV;
- Foto personale;
- Kopje e Pasaportës;
- Listë notash të studimeve Bachelor deri në momentin e aplikimit (per studentët Bachelor);
- Listë notash e studimeve Master deri në momentin e aplikimit (për studentët Master i Shkencave);
- Diplomë e nivelit Bachelor (fotokopje, për studentët Master i Shkencave);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze, franceze ose italiane);
- Certifikatë e gjuhës franceze, niveli minimal i përcaktuar B2 për aplikim në UTC Bachelor;
- Certifikatë e gjuhës italiane, niveli minimal i përcaktuar B2 për aplikim në UNIGE Bachelor;
- Certifikatë e gjuhës angleze , niveli minimal i përcaktuar B2;
- Dokumenti Learning Agreement (pasi te shpallenit fitues)*.

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*



KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Teknologjik te Copmiegne (UTC), lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës. Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Afati për aplikim për studentët: deri më 25 Nëntor 2020

Aplikimi kryhet pranë zyrës së Projekteve në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit në Dekanat (tek asistentja e Dekanit). Dokumentat e cituara më sipër duhet të dorëzohen në hard copy të firmosura dhe të nisen edhe elektronikisht me email te Suada Bylyku, email: sbylyku@fti.edu.al

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit mund të kontaktoni Prof. Elinda Meçe , në email: ekajo@fti.edu.al

Për më shumë informacion mbi UTC, Francë mund të kontaktoni me Prof. Dritan Nace, email: dritan.nace@hds.utc.fr

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: zyraekarrieres@upt.al